

-  
=



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 1249/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Ujup Arifi – Kandidatë për Asamble Komunale (AAK) dega në Prishtinë paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të mungesës së votave, të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohen si të pabazuara ankesat:** Anr.1249, Anr.1250, të datës 03.12.2013, të Ujup Arifit– Kandidatë për Asamble Komunale (AAK) dega në Prishtinë.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.1249, Anr.1250, të datës 03.12.2013, të Ujup Arifit–Kandidatë për Asamble Komunale nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Prishtinë, në të cilat ankesa pretendon se dyshon se ka pasur keqpërdorime dhe mungesë të votave.

- Në ankesën Anr.1249/13 të datës 03.12.2013, ka pretenduar se në VV1921E/1 N nuk janë numëruar votat e familjarëve dhe kërkoirinumërimin e votave.
- Në ankesën Anr.1250/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në VV1921/E nga komisionarët e AAK-së janë raportuar 19 vota, kurse nga rezultatet përfundimtare ky ndryshim është 9 vota.

Bazuar në nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat gjeti se:

## **Ankesat janë të pa bazuara**

Pretendimet ankimore nga ana e Ujup Arifit– Kandidatë për Asamble Komunale (AAK) dega në Prishtinë , paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), ku dyshohet për pa rregullsi dhe keqpërdorime si dhe mungesës së konsiderueshme të votave nëpër QV, mirëpo nuk është ofruar asnjë provë relevante nga ana e palës ankuese, me të cilat do të mund të vërtetoheshin shkeljet e supozuara.

Prandaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar pa rregullsi dhe keqpërdorime gjatë procesit të votimit në QV, të lartcekura nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar dhe ankesat e lartpërmendura u refuzuan si të pa bazuara, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesat e lartë përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 1249/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Munarrem Shala**



**Këshillë juridike:** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.